

Programi “LEAD Albania”
Program për Përvojë dhe Zhvillim Lidershipi në Shqipëri

Një nismë e Fondacionit Shqiptaro – Amerikan për Zhvillim

MODEL APLIKIMI*

*Ky dokument është vetëm për qëllime referimi dhe planifikimi. Aplikimi duhet të dorëzohet nëpërmjet sistemit online. Aplikimi online do të jetë i disponueshëm duke nisur nga data 15 janar, 2018 ora 17:00, dhe duhet të dorëzohet i plotë jo më vonë se data 15 mars, 2018 ora 17:00.

Ju lutemi të vizitoni www.aadf.org/lead për të nisur aplikimin dhe për të marrë udhëzimet e plota se si të dërgoni aplikimin.

Përgatitja e një aplikimi të qartë, të plotë dhe konkurrues vlerësohet të zgjasë të paktën 25 orë, prandaj ju lutemi ta nisni këtë proces sa më shpejt që të jetë e mundur.

Vetëm shtetasit shqiptarë kanë të drejtë të aplikojnë. Personat, të cilët punojnë aktualisht në institucione të qeverisjes qendrore (Kryeministri apo Ministri) ose në Institucionin e Presidentit, NUK lejohen të aplikojnë. Aplikantët duhet të kenë përfunduar studimet në arsimin e lartë dhe të kenë përvojë pune në profesionet e zgjedhura. Nuk mund të merren parasysh aplikimet nga persona, të cilët nuk i plotësojnë kushtet për të aplikuar apo të bëhen përjashtime nga këto kërkesa.

Përzgjedhja bazohet në kualifikime dhe aftësi të shtetasve shqiptarë pavarësisht nga përkatësia etnike apo kulturore, besimi, feja, gjinia, moshë apo orientimi seksual.

1. TË DHËNA PERSONALE

EMRI, MBIEMRI

Jeni shtetas shqiptar?

Po Jo

Keni shtetësi tjetër përveç asaj shqiptare?

Po Jo

NËSE PO, ÇFARË SHTETËSIE?

DATËLINDJA (DITA/MUAJI/VITI)

VENDLINDJA

PROFESIONI

ADRESA POSTARE

VENDBANIMI, RRETHI, KODI POSTAR

TELEFON

CELULAR

E-MAIL

NUMRI PERSONAL (Në kartën e identitetit)

Të dhëna punësimi

EMRI I PUNËDHËNËSIT TUAJ AKTUAL

ADRESA E PUNËDHËNËSIT TUAJ AKTUAL

TELEFONI I PUNËDHËNËSIT TUAJ AKTUAL

TITULLI / POZICIONI JUAJ

Punoni aktualisht për institucione qeveritare në nivel qendror ose vendor ose jeni duke shërbyer në detyra aktive në Forcat e Armatosura?
Nëse po, lutemi të sqaroni më poshtë.

Po Jo

Si mësuat rreth Programit "LEAD Albania"?

Website (aadf.org)

Aktivitet

Website i institucioneve pritëse

Media

Media sociale (Facebook/Twitter
Linkedin)

Mik/koleg

Nga Universiteti

Email

Të tjera _____

Zotëroni një diplomë të studimeve të larta në çfarëdo disipline/fushe?

Po Jo

Nëse ende jo, a parashikoni të diplomoheni brenda datës 15 mars 2016?

Po Jo

2. DEKLARATA PERSONALE

Ju lutemi përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme dhe shpjegoni pyetjet, të cilava u jeni përgjigjur me “Po”.

1. Keni qenë ndonjëherë i dënuar për ndonjë vepër penale? Po Jo

2. Keni qenë ndonjëherë i akuzuar për ndonjë vepër penale? Po Jo

3. Keni qenë ndonjëherë i pezulluar, i dënuar apo ju është ndaluar të ushtroni profesionin apo veprimtarinë tuaj nga ndonjë ent/institucion/agjenci rregullatore, shoqatë apo organizatë profesionale për shkak të sjelljes suaj?
Po Jo

4. Ka ndonjë gjë në të kaluarën tuaj që mund t'ju pengojë në marrjen e certifikatës së sigurisë?
Po Jo

5. Keni punuar ndonjëherë apo jeni duke punuar për institucione shtetërore, ose jeni duke u paguar nga fondet shtetërore (përfshirë shërbimin ushtarak aktiv në detyrë)?
Po Jo

6. (Për personelin ushtarak aktiv në detyrë) Unë deklaroj se eprori ushtarak dhe ata që më caktojnë detyrat, më kanë dhënë leje për të aplikuar për Programin “LEAD Albania” dhe kanë miratuar shkëputjen time njëvjeçare për kohëzgjatjen e Programit.
Po Jo
Jo e zbatueshme

7. Jeni liruar ndonjëherë nga Forcat e Armatosura përveçse me nderime?
Po Jo
Po Jo

Nëse jeni përgjigjur “PO” për ndonjë nga pyetjet e mësipërme, lutemi të jepni detaje të mëtejshme. Lutemi t’u referoheni numrave të pyetjeve përkatëse në përgjigjet tuaja.

3. INFORMACION RRETH REKOMANDUESVE

Aplikantët duhet të japin emrat dhe të dhënat e kontaktit të rekomanduesve. Këta individë, **në rast të kalimit në fazën e parë të përzgjedhjes**, kontaktohen nga Programi me anë të një mesazhi në adresën e postës së tyre elektronike dhe u kërkohet të shkruajnë dhe të dorëzojnë letrën e rekomandimit.

Aplikantët nuk mund të shohin letrat e rekomandimit. Një mesazh konfirmimi do të dërgohet në adresën e postës elektronike të aplikantëve menjëherë pasi çdo letër rekomandimi është dorëzuar.

Aplikantët duhet të dorëzojnë tre letra rekomandimi, por mund të japin katër emra nëse dëshirojnë. Vetëm tre letrat e para të rekomandimit do të merren parasysh.

Letrat e rekomandimit janë jashtëzakonisht të rëndësishme dhe ato duhet të përmbajnë informacion rreth jush, që nuk është përmendur në aplikimin tuaj. Këshillohet që rekomandimet të vijnë nga individë, të cilët ju njohin mirë. Një rekomandim nga një individ i famshëm nuk ju ndihmon, nëse ai individ nuk ju njeh personalisht. Ju lutemi të mbani parasysh që anëtarët e Komisionit Përzgjedhës të Programit “LEAD Albania” nuk lejohen të japin letra rekomandimi.

Këshillohet që një rekomandim të jetë nga një individ, i cili mund të flasë për kompetencat dhe arritjet tuaja profesionale në fushën tuaj, dhe të paktën një rekomandim nga dikush që njeh veprimtaritë tuaja në komunitet dhe ato qytetare. Rekomandimi i fundit duhet të jetë nga eprori juaj aktual. Një rekomandim nga një epror i mëparshëm është gjithashtu i pranueshëm. Letrat e rekomandimit nuk duhet të jenë më shumë se dy faqe.

REKOMANDUES 3

EMRI

EMAIL / TELEFON

REKOMANDUES OPSIONAL 4

EMRI

EMAIL / TELEFON

REKOMANDUES 1

EMRI

EMAIL / TELEFON

REKOMANDUES 2

EMRI

EMAIL / TELEFON

4. JETËSHKRIMI

A. TË DHËNA RRETH ARSIMIMIT DHE PUNËSIMIT

ARSIMIMI

Ju lutemi të jepni në mënyrë kronologjike informacione rreth të gjitha institucioneve arsimore që keni ndjekur, duke filluar nga ai më i fundit. Duhet të përfshini edhe shkollën e mesme. Listoni kualifikimin ose diplomën e arritur, emrin e shkollës, vendin dhe datat përkatëse (nëse nuk keni një datë të saktë të muajit, atëherë mund të shënoni datën 1 të atij muaji)! Sipas rastit, ju kërkohet të listoni edhe veprimtaritë jashtëkurrikulare dhe nivelin tuaj të përfshirjes. Shënoni çmimet dhe vlerësimet e marra!

Shembull: 2003 - 2005
Lloji i kualifikimit/diplomës: Master
Emërtimi: Master në Administrim Publik
Universiteti / Qyteti / Shteti

PUNËSIMI

Ju lutemi të jepni në mënyrë kronologjike informacione rreth çdo roli ose pozicioni pune, që ju keni mbajtur/kryer që nga diplomimi në universitet, duke filluar nga ai më i fundit. Shënoni edhe të gjitha periudhat, në të cilat nuk keni qenë në marrëdhënie pune!

Datat e punësimit
Roli ose pozicioni
Adresa dhe numri i telefonit i punëdhënësve
Numri i punonjësve, të cilët keni mbikëqyrur

Për çdo përvojë profesionale, përshkruani natyrën e punës dhe arritjet profesionale (jo më shumë se 100 fjalë)

Shembull: **10/10 - aktualisht**
Zv.Drejtor, Emri i Fondacionit
Rruga xxx, Nr. 000
Tirana 10000
Turizëm dhe trashëgimi kulturore
Mbikëqyrur 10 punonjës

4/10 to 10/10
I/e papunë
Në kërkim pune

B. VEPRIMTARI VULLNETARE DHE ÇMIME

VEPRIMTARI VULLNETARE dhe QYTETARE

Ju lutemi të jepni në mënyrë kronologjike informacione rreth veprimtarive tuaja vullnetare, qytetare dhe profesionale më të rëndësishme, ku ju keni marrë pjesë në dhjetë vitet e fundit, duke filluar nga ai më i fundit.

Emri i organizatës
Qyteti / Shteti
Qëllimi/objektivi i organizatës
Madhësia e organizatës
Niveli i pjesëmarrjes
Datat e pjesëmarrjes
Çmimet ose vlerësimet që keni marrë

ÇMIME dhe PUBLIKIME

Ju lutemi të jepni në mënyrë kronologjike të gjitha çmimet ose publikimet e rëndësishme, duke nisur nga ato të fundit (jo më shumë se pesë vitet e fundit).

5. GJUHËT E HUAJA / AFTËSITË PERSONALE DHE KOMPETENCAT

Gjuhë të huaja – Jepni nivelin tuaj të njohurive sipas kësaj skeme (1=dobët, 2=kënaqshëm, 3=mirë, 4=shumë mirë, 5=shkëlqyeshëm):

_____	Të lexuarit	Të dëgjuarit	Të shkruarit
_____	Të lexuarit	Të dëgjuarit	Të shkruarit
_____	Të lexuarit	Të dëgjuarit	Të shkruarit
_____	Të lexuarit	Të dëgjuarit	Të shkruarit

Aftësi dhe kompetenca sociale (përshkruajini dhe tregoni se ku janë fituar ato).

Aftësi dhe kompetenca organizative (përshkruajini dhe tregoni se ku janë fituar ato).

Aftësi teknike dhe kompetenca (përshkruajini dhe tregoni se ku janë fituar ato).

Aftësi dhe kompetenca kompjuterike (përshkruajini dhe tregoni se ku janë fituar ato).

Aftësi dhe kompetenca artistike (përshkruajini dhe tregoni se ku janë fituar ato).

Aftësi dhe kompetenca të tjera (përshkruajini dhe tregoni se ku janë fituar ato).

Leje drejtimi (përcaktoni këtu nëse zotëroni një leje drejtimi automjeti të vlefshme dhe për cilën kategori automjetesh).

Informacion shtesë (shtoni këtu çdo informacion tjetër që mendoni se mund të jetë i vlefshëm)

6. SEKSIONI I ESEVE

Ju do të vlerësoheni në lidhje me qartësinë dhe cilësinë e të shkruarit tuaj si edhe për përmbajtjen.

A. PUNËSIMI AKTUAL

Jepni një përshkrim të shkurtër të punës, të cilën kryeni aktualisht. Ky përshkrim duhet të thellojë dhe jo të përsërisë informacionin e dhënë në pjesën e të dhënave rreth punësimit. Ju lutemi të kufizoheni në 200 fjalë.

B. KONTRIBUTET

Përshkruani se çfarë konsideroni të jenë arritjet tuaja më të rëndësishme profesionale ose vullnetare, të cilat lidhen me interesin tuaj për sektorin publik! Çfarë ndikimi kanë patur ato? Gjithashtu, përshkruani se çfarë shpresoni të arrini në të ardhmen bazuar në këto kontribute! Ju lutemi të kufizoheni në 500 fjalë.

C. MEMORANDUM PËR KREUN E INSTITUCIONIT

Lutemi të zgjidhni institucionin, në të cilin preferoni të vendoseni, nëse përzgjidhni të jeni pjesë e Programit "LEAD Albania" (lista përmban Presidencën, Qeverinë (Kryeministrinë ose Ministrinë), Bashkinë Tiranë).

Lutemi të shkruani një memorandum për kreun e institucionit të preferuar duke bërë një propozim konkret për një politikë të caktuar. Duhet të sqaroni se pse mendoni që politika e propozuar nga ju është e rëndësishme, çfarë çështjesh trajton ajo, dhe pse mendoni që propozimi juaj duhet të mbështetet. Ju lutemi të kufizoheni në 500 fjalë.

D. MOTIVIMI PËR T'U BËRË PJESE E PROGRAMIT (në gjuhën angleze)

Përshkruani motivimin tuaj për të aplikuar për Programin "LEAD Albania"! Cilat konsideroni se janë pikat tuaja më të forta dhe kualifikimet më të rëndësishme për programin? Çfarë përfitimesh mendoni se do të rezultojnë për shoqërinë nga pjesëmarrja juaj? Ju lutemi të kufizoheni në 300 fjalë.

Kjo pjesë duhet të plotësohet në gjuhën angleze dhe shërben edhe për të treguar aftësitë e aplikantit për të shkruar në këtë gjuhë.

7. CERTIFIKIMI I INFORMACIONIT

A. Aplikantët duhet të deklarojnë që informacioni i dhënë është i vërtetë. Në rast se nuk deklaroheni kështu, atëherë aplikimi juaj nuk do të merret në konsideratë.

Po, vërtetohet që: (1) i gjithë informacioni në këtë aplikim është puna ime; dhe (2) të gjitha deklaratat janë të vërteta, të plota dhe paraqitur me ndershmëri.

Aplikantëve u kërkohet që të pranojnë që të gjitha aplikimet e plotësuar do të shqyrtohen edhe nga persona të jashtëm me porosi të Fondacionit Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim (AADF). Gjithashtu, finalistët, të cilët do t'u rekomandohen institucioneve pritëse, mund të kenë nevojë t'u nënshtrohen verifikimeve nga autoritetet shqiptare. Në rast se nuk pranoni këtë deklaratë, atëherë aplikimi juaj nuk do të merret në konsideratë.

Po, pranoj dhe kuptoj që aplikimi im mund të shqyrtohet nga persona të autorizuar nga Fondacioni Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim dhe në rast se zgjidhem si finalist, pranoj t'u nënshtrohem verifikimeve nga autoritetet shqiptare.

POLITIKA E PRIVATËSISË

Dorëzimi i informacioneve dhe të dhënave personale është vullnetar dhe AADF-ja i mbledh ato vetëm për qëllime të vlerësimit të aplikimeve. Të dhënat përdoren në përputhje me legjislacionin shqiptar për privatësinë.

APLIKIMI PËR PROGRAMIN “LEAD ALBANIA” LETRAT E REKOMANDIMIT

Faleminderit që gjeni kohën për të dhënë një rekomandim për aplikantin XXXXXXX për Programin “LEAD Albania”. Vlerësimi juaj i sinqertë për aplikantin do të ndihmojë Komisionin Përzgjedhës të përcaktojë grupin e pjesëmarrësve, një grup i vogël udhëheqësish të mundshëm për sektorin publik, i cili do të zgjidhet për të punuar për një vit si këshilltarë ose ndihmës me kohë të plotë në pozicione të larta në stafet drejtuese të institucioneve të larta shtetërore si Kryeministria, Zyra e Presidentit, Ministrinë apo Bashkia Tiranë.

Kandidatët e përzgjedhur duhet të tregojnë nivel të lartë integriteti, të demonstrojnë interes për sektorin publik dhe të tregojnë potencial lidhshpi në fushat e tyre, në mënyrë që të dyja palët të kontribuojnë dhe të përfitojnë nga puna e një viti pranë institucioneve të larta shtetërore. Në rast se kërkon informacion të mëtejshëm rreth programit, ju lutemi të vizitoni www.aadf.org/lead.

Udhëzime rreth letrave të rekomandimit

Letrat e rekomandimit janë konfidenciale dhe duhet të dërgohen nëpërmjet sistemit online të aplikimit. Aplikantët do të marrin një email, ku konfirmohet dërgimi i letrës së rekomandimit nga ana juaj. Letra nuk duhet të jetë më shumë se 2 faqe, duke përdorur një madhësi shkrimi 12. Ju mund të zgjidhni formatin e letrës së rekomandimit, por zakonisht përdoret një letër rekomandimi tradicionale. Ju lutem të theksoni përvojat tuaja personale që keni ndarë me aplikantin, të cilat vlerësojnë në mënyrë të ndershme cilësitë e tij/e saj prej lideri, karakterin dhe angazhimin për sektorin publik. Preferohet një letër me kokë, ose minimalisht, ju lutemi të përfshini emrin e organizatës suaj dhe të dhënat e kontaktit në krye të letrës tuaj të rekomandimit.

Ju lutemi përdorni pyetjet e mëposhtme si udhërrëfyes:

- Prej sa kohësh dhe në çfarë cilësie e njihni aplikantin?
- Cilat janë pikat e forta kryesore të aplikantit? Ju lutemi t'i referoheni një rasti, ku këto pika të forta janë demonstruar.
- Cilat janë pikat e dobëta kryesore të aplikantit? Ju lutemi t'i referoheni një rasti, ku këto pika të dobëta janë demonstruar.
- Shpjegoni se pse mendoni që kandidati është i interesuar për sektorin publik dhe si mund të përfitojë nga Programi.

Shënime të rëndësishme:

- Për të ngarkuar letrën tuaj të rekomandimit lutemi të klikoni linkun më poshtë dhe të ndiqni udhëzimet përkatëse.

[LINKU](#)

- Ju gjithashtu mund ta dërgoni letrën tuaj të rekomandimit në adresën leadalbania@aadf.org.
- Afati i dorëzimit të aplikimeve të plota është data xxx.
- Formatet e mëposhtme të skedarëve pranohen: DOC (MS Word 2002), DOCX (MS Word 2007, 2010), PDF (Adobe Reader format), TXT (Text file), RTF (Rich Text Format) ose JPG (graphic).